"PIRRO" sh.p.k

Selia: Gjin Bue Shpata

Tiranë – Albania

Pasqyrat Financiare për periudhën e mbyllur me 31 Dhjetor 2020

Tiranë, 31 Mars 2021

Përmbajtja

1. Bilanci Kontabël
2. Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve
3. Pasqyra e flukseve monetare
4. Pasqyra e ndryshmeve në kapital
5. Shënime

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHE SHKRUHET

Pasqyra e Situatës Financiare datë 31 Dhjetor 2020

	AKTIVET	Shen	2020	2019
I	**Aktivet Afatshkurtëra**			
1	**Aktive monetare**	4	**3,177,612**	**5,373,628**
3	**Aktive të tjera financiare afatshkurtra**			
(i)	*Llogari/Kërkesa të arkëtueshme*	5	3,557,050	3,635,972
(ii)	*Llogari/Kërkesa të tjera të arkëtueshme*	6	1,084,994	899,837
	Totali 3		**4,642,044**	**4,535,809**
4	**Inventari**			
(i)	*Lëndët e para*	7	61,031,083	60,144,341
(ii)	*Prodhim në proces*	7	0	0
(iii)	*Produkte të gatshme*	7	12,474,795	13,021,872
(v)	*Materiale te tjera Inventar I imet*	7	5,542,029	3,667,282
	Totali 4		**79,047,907**	**76,833,495**
7	**Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra**	8	3,118,815	347,491
	Total i Aktiveve Afatshkurtra (I)		**89,986,379**	**87,090,422**
II	**Aktivet afatgjata**			
2	**Aktive afatgjata materiale**			
(i)	Toka	9	22,612,350	22,612,350
(ii)	*Ndërtesa*	9	49,232,708	51,290,984
(iii)	*Makineri dhe pajisje*	9	82,013,791	90,387,185
(iv)	*Aktive të tjera afatgjata materiale (me vl.kontab.)*	9	10,006,972	10,738,626
(v)	*Parapagime per aktive afatgjata materiale*	9	0	0
	Totali 2		**163,865,821**	**175,029,144**
4	**Aktive afatgjata jomaterial**			
	Aktive të tjera afatgjata jomateriale	9	**61,175**	**71,970**
6	**Aktive financiar afatgjata**			
	Te drejta te tjera afatgjata	10	**3,607,905**	**4,557,180**
	Totali i aktiveve Afatgjata (II)		**167,534,900**	**179,658,294**
	TOTALI I AKTIVEVE (I + II)		**257,521,279**	**266,748,716**
	DETYRIMET DHE KAPITALI			
I	**DETYRIMET Afatshkurtëra**			
2	**Huamarrjet**			
(i)	*Huat dhe obligacionet afatshkurtra*	11	2,769,411	15,013,663
3	**Hunt dhe parapagimet**			
(i)	*Të pagueshme ndaj furnitorëve*	12	11,351,528	12,234,488
(ii)	*Të pagueshme ndaj punonjësve*	13	1,460,129	1,349,860
(iii)	*Detyrime tatimore*	14	706,475	711,203
(iv)	*Hua të tjera*	15	75,347,129	67,004,864
(v)	*Parapagimet e arkëtuara*		-	-
	Totali i detyr. afatshkurtra (I)		**91,634,673**	**96,314,078**
II	**DETYRIME AFATGJATA**		-	-
2	*Huamarrje të tjera afatgjata*	16	68,492,159	72,348,270
	Totali i detyr. afatgjata (II)		**68,492,159**	**72,348,270**
	Totali i detyrimeve		**160,126,831**	**168,662,348**
III	**Kapitali**			
(i)	Kapitali aksionar	17	61,000,000	61,000,000
(ii)	Rezerva ligjore	17	9,752,179	9,752,179
(iii)	Rezerva të tjera	17	1,767,656	79,542
(iv)	Fitimet e pashpërndara	17	23,878,534	23,878,534
(v)	Fitimi (humbja) e vitit financiar	17	996,079	3,376,114
	Totali i kapitalit (III)		**97,394,448**	**98,086,369**
	TOTALI I DETYRIMEVE KAPITALIT		**257,521,279**	**266,748,717**

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-25

Pasqyra e të Ardhurave gjithpërfshirëse për periudhën që përfundon më 31.12.2020

Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve		Periudha 2020	Periudha 2019
(sipas natyres) - e detyrueshme			
Shitjet neto	*18*	111,395,046	134,493,336
Te ardhura te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit	*18.1*	13,367	78,513
Ndryshimet ne inventarin e produkteve te gateshme dhe punes ne proces	*18.2*	-547,077	-9,453,434
Puna e kryer nga njesia ekonomike raportuese per qellimet e veta dhe e kapitalizuar			
Mallrat, lendet e para dhe sherbimet	*19*	-55,637,650	-61,294,645
Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit			
Shpenzime te personelit		-17,769,876	-17,899,018
Pagat	*20*	-15,210,283	-15,340,520
Shpenzimet e sigurimeve shoqerore dhe shendetsore	*20*	-2,559,593	-2,558,498
Amortizimi		-15,003,887	-23,195,578
Shpenzime te tjera	*21*	-18,629,853	-16,461,999
Fitimi/(humbja) nga veprimtarite e shfrytezimit		**3,820,069**	**6,267,175**
Te ardhura e shpenzime financiare			
Te ardhurat/(shpenzimet) nga interesi	*22*	-2,053,621	-1,991,565
Fitime/(humbje) nga kurset e kembimit	*23*	-214,146	175,134
Te tjera te ardhura/(shpenzime) financiare			
Shuma		-2,267,767	-1,816,431
Fitimi/(humbja) para tatimit		1,552,302	4,450,744
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	*24*	-556,223	-1,074,630
Fitimi/(humbja) neto e periudhes financiare		**996,079**	**3,376,114**
Të Ardhura të Tjera gjithpërfshirëse			
Fitimi (Humbje) nga rivlerësimi i AAM		-	-
Fitimi (Humbje) nga rivlerësimi i AAFinacniare			
Totai i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse neto nga tatimet			
Totali i të ardhurave neto gjithpërfshirëse për periudhën		996,079	3,376,114

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-25

Pasqyrat Financiare "Pirro shpk" janë aprovuar nga Drejtimi i Shoqërisë
Më datë 31 Mars 2020

Hartuesi

Kejsi Delia

Administratori

Spiro Ruco

PIRRO JEWELLERY

Pasqyra e ndryshimit të flukseve te mjeteve monetare për periudhën që përfundon më 31.12.2020

Pasqyra e Flukseve Monetare 2020			
	Shen	2020	2019
Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit			
Fitimi para tatimit	24	1,552,302	4,450,744
Rregullime për:			
Tatim Fitimin e Njohur ne PASH	24	-556,223	-1,074,630
Amortizimi i Aktive Afagjata	9	15,003,887	23,195,578
		15,999,966	26,571,691
Rritje/rënie në tepricën e Llogari/Kërkesa të arkëtueshme	5	78,922	4,178,600
Rritje/rënie në tepricën e Llogari/Kërkesa të arkëtueshme te tjera	6	764,118	-5,410,102
Rritje/rënie në tepricën inventarit		-2,214,412	-14,108,285
Rritje/rënie në Shpenzimet e Shtyra	8	-2,771,324	-223,736
Rritje/rënie në tepricën e Llogarive te Pagueshme (Furnitoreve)	11	-882,960	6,558,893
Rritje/Rënie në detyrimet ndaj punonjësve	12	110,269	346,078
Rritje/rënie në tepricën e Detyrimeve tatimore	13	-4,728	-778,074
Huamarrje afatshkurter - Overdraft	10	-12,244,251	3,069,147
Rritje/rënie në Hua te tjera	14	8,342,265	9,310,051
Rritje/rënie në Parapagime te arketuara	14.1	-	-
Interesi i Paguar		-	-
Tatim mbi fitimin i paguar		-	-
		-8,822,102	2,942,573
MM Neto nga aktivitetet e shfrytëzimit		**7,177,864**	**29,514,264**
Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese			
Pagesa per Blerja e aktiveve afatgjata	9	-5,084,101	-41,920,895
Arketime nga shitja/nxjerrja Jashte perdorimit e aktiveve afatgjata materiale		1,254,333	-
MM neto, e përdorur në aktivitetet investuese		-3,829,768	-41,920,895
Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare			
Rritje/pakesime huamarrje afatgjata	14	-3,856,111	21,722,462
Dividente te paguar		-1,688,000	-6,759,593
MM neto e përdorur në aktivitetet financiare		-5,544,111	14,962,869
Rritja/rënia neto e mjeteve monetare		-2,196,016	2,556,239
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël		5,373,628	2,817,388
Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël		3,177,612	5,373,628

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-25

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHE SHKRUHET

Pasqyra e ndryshimit të kapitalit aksionar për periudhën Janar - Dhjetor 2020

Pasqyra e ndryshimit të kapitalit aksionar për periudhën Janar - Dhjetor 2020					
	Kapitali aksionar	Rezerva ligjore	Rezerva te tjera	Fitimi i Pashpërndarë	Totali
Pozicioni më 31 dhjetor 2017	**61,000,000**	**9,752,179**	**79,542**	**28,095,696**	**98,927,417**
Emetim i kapitalit aksionar	**0**				**-**
Fitimi (humbja) neto i periudhës kontabël				**2,542,432**	**2,542,432**
Rritje/ Pakesim rezerva ligjore, te tjera					**-**
Pozicioni më 31 dhjetor 2018	**61,000,000**	**9,752,179**	**79,542**	**30,638,127**	**101,469,848**
Emetim i kapitalit aksionar	**0**				**0**
Fitimi (humbja) neto i periudhës kontabël				**3,376,114**	**3,376,114**
Rritje/ Pakesim rezerva ligjore, te tjera					**0**
Dividente te paguar				**-6,759,593**	**-6,759,593**
Pozicioni më 31 dhjetor 2019	**61,000,000**	**9,752,179**	**79,542**	**27,254,648**	**98,086,369**
Emetim i kapitalit aksionar	0				**0**
Fitimi (humbja) neto i periudhës kontabël				996,079	996,079
Rritje/ Pakesim rezerva ligjore, te tjera			1,688,114	-1,688,114	**0**
Dividente te paguar				-1,688,000	**-1,688,000**
Pozicioni më 31 dhjetor 2020	**61,000,000**	**9,752,179**	**1,767,656**	**24,874,613**	**97,394,448**

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-25

PIRRO
ARTISTIC JEWELLERY

"P I R R O" SHPK
NUIS K31419099E
TIRANE

VENDIM
I ORTAKUT TË VETËM
DATË 30.01.2021

Në mbështetje të ligjit nr 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare", ligji nr 9723 dt 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" dhe ligjit nr 10091 dt 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe kontabilistit të miratuar".

Ortaku i shoqërisë Z.Spiro Ruço:

VENDOSI

Të emërojë shoqërinë audituese Studio L. E. A. L. Auditing me nipt K83814801N, si auditues ligjore, për të audituar pasqyrat financiare të vitit 2020.

Per Asamblenë e Ortakëve
ORTAKU I VETEM
SPIRO RUÇO

PIRRO ARTISTIC JEWELLERY

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Ortakut të shoqërisë
"P I R R O" Shpk
Rruga"Gjin Bue Shpata",5/1
Tiranë - Shqipëri

Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë tregtare ***"PIRRO"***sh.p.k.(shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2020, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur me daten 31 Dhjetor 2020, si edhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tone, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të shoqërisë tregtare ***"PIRRO"*** sh.p.k., me datën 31 Dhjetor 2020, dhe performancën financiare e flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Ligjin nr. 25/2018 date 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe me Standardet Kombetare te Kontabilitetit qe zbatohen ne Shqiperi.

Baza për Opinionin

Ne kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi te pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqiperi, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojme se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tone.

Përgjegjësia e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare që japin një pamje të vërtetë e të drejtë në përputhje me Ligjin nr. nr. 25/2018 date 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe Standardet Kombetare te Kontabilitetit dhe për ato kontrolle të brendëshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak mashtrimit apo gabimit

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vleresuar aftesinë e Shoqerisë për te vazhduar në vijmësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijmësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijmësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetin, ose nuk ka alternativë tjeter reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqerisë.

Përgjegjësia e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që te arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimi apo të gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e aresyeshme është një siguri e

nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.
Anomalitë mund të vijne si rezultat i gabimit ose mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të aresyeshme të influencojë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjese e auditimit ne perputhje me SNA-te, ne ushtrojme gjykimin profesional dhe ruajme skepticizmin profesional gjate gjithe auditimit. Ne gjithashtu:

- Idetifikojme dhe vleresojme rreziqet e anomalise materiale, qofte per shkak te mashtrimit ose gabimit, hartojme dhe kryejme procedurat e auditimit ne pergjigje te ketyre rreziqeve, dhe marrim evidence auditimi qe eshte e mjaftueshme dhe e pershtatshme per te siguruar nje baze per opinionin tone. Rreziku i moszbulimit te nje anomalie materiale si rezultat i mashtrimit eshte me i larte se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund te perfshije marreveshje te fshehta, falsifikime, perjashtime te qellimshme, informacione te deformuara, anashkalime te kontrolleve te brendshme.
- Sigurojme nje njohje te kontrollit te brendshem qe ka te beje me auditimin me qellim qe te percaktojne procedurat e auditimit qe jane te pershtatshme sipas rrethanave, por jo per qellime te shprehjes se nej opinioni mbi efikasitetin e kontrollit te brendshem te Shoqerise.
- Vleresojme pershtatshmerine e politikave kontabel te perdorura dhe aresyeshmerine e cmuarjeve kontabel dhe te shpjegimeve perkatese te bera nga drejtimi.
- Nxjerrim nje konkluzion ne lidhje me pershtatshemrine e perdorimit te bazes kontabel te vijmesise, dhe bazuar ne evidencen e auditimit te marre, nese ka nje pasiguri materiale ne lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund te hedhe dyshime te medha per aftesine e Shoqerise per te vijuar veprimtarine.Nese ne arrijme ne perfundimin qe ka nje pasiguri ne duhet te terheqim vemendjen ne raportin e audituesit ne lidhje me shpjegimet e dhena ne pasqyrat financiare, ose nese keto shpjegime jane te pershtatshme, duhet te modifikojme opinionin tone.Konkluzionet tona bazohen ne evidencen e auditimit te marre deri ne daten e raportit tone te auditimit.Megjithate, ngjarja ose kushtet te ardhshme mund te bejne qe Shoqeria te nderprese veprimtarine.

Ne komunikojme me personat e ngarkuar me qeverisjen, pervec te tjerave, lidhur me qellimin dhe kohen e auditimit dhe gjetjet e rendesishme te auditimti, perfshire ndonje mangesi te rendesishme ne kontrollin e brendshem qe ne mund te identifikojme gjate auditimit.

Eda ABAZI

Studio L.E.A.L. Auditing Sh.p.k Cel. 069 22 63 196

Auditues Ligjor (EKR)

Datë : 31 Mars 2021
Adresa:Lagje Nr.4, Sarande
Sarandë –Albania

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria PIRRO sh.p.k, në vijim e quajtur "Shoqëria", është themeluar sipas aktit të themelimit më datën 01.02.2001. PIRRO sh.p.k është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Kapitali eshte ndare ne 1 kuota me vlere prej 61.000.000 lekë. Në datën e këtyre PF struktura e zotërimit të kapitalit paraqitet si vijon:

Emri i ortakut	Numri i pjeseve	% e kapitalit
Spiro Ruco	1	100
Totali	**1**	**100**

Shoqeria eshte e regjistruar si person juridik në Drejtorinë Rajonale Tatimore të Tiranes me NIPT K31419099E.

Më 31 Dhjetor 2020 shoqëria ka 40 punonjës.

Aktivitet kryesor i shoqërisë, është Import eksport, perpunim argjendi dhe ari, si unaza, varese,medaljone,zinxhire,vathe etj. Prodhim te suvenireve me baker,argjend, te lara ne ar ose argjend. Punime medalje.
Administratori ligjor i shoqërisë është Z. Spiro Ruco.
Adresa e Shoqërisë është : Gjin Bue Shpata, 5/1, Tiranë, Shqipëri.

2. Parimet e pergatitjes se pasqyrave financiare

(a) Deklarata e parimeve kontabel

Shoqëria mban regjistrimet kontabël dhe përgatit pasqyrat financiare në perputhje me legjislacionin kontabël në Shqipëri.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në perputhje me Ligjin Nr. 25/2018 date 10 Maj 2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe Standardet Kombetare te Kontabilitetit 1-14 (SKK) të përmirësuara të shpallura me urdhërin e Ministrit të Financave nr 64 dt 22.07.2014.

(b) Parimet e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit te kostos historike.

Politikat kontabël janë zbatuar në përputhje me kërkesat e SKK të përmirësuara dhe të ligjit nr. 25/2018 date 10 Maj 2018 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe paraqiten në shënimin vijues.

3. Politikat kontabël kryesore

Nje permbledhje te pjeses me te madhe te politikave kontabel mbi bazen e te cilave jane pergatitur pasqyrat financiare jane paraqitur sa me poshte:

3.1 Transaksionet me monedhat e huaja

a. Konvertimi i transaksioneve në monedhë të huaj

i) Monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes

Zërat e përfshirë në pasqyrat financiare vlerësohen duke përdorur monedhën e mjedisit ekonomik kryesor në të cilin operon njësia ("monedha funksionale"). Pasqyrat financiare në Shqipëri paraqiten në Lekë (All), e cila është monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes.

ii) Transaksionet dhe tepricat

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në fund të periudhës kontabël, aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit të kësaj datë. Diferencat nga konvertimi, fitimet ose humbjet, paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, në zërin "Të tjera të ardhura/shpenzime" për diferencat e lidhura me kërkesat për t'u arkëtuar dhe detyrimet ndaj furnitorëve, dhe në zërin "Fitime/humbje nga këmbimi" në rastin e mjeteve monetare.

Kurset e këmbimit të përdorura për konvertimin e zërave monetarë në datën 31 Dhjetor 2020 janë:

Data / Monedha	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Euro	123.70	121.77
USD	100.84	108.64
GBP	137.93	143
CHF	114.46	112.3

3.2 Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre perfshijne MM ne arke dhe ato te mbajtura ne banka. Në përputhje me SKK 7 "Pasqyra e fluksit të Mjeteve Monetare", Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në pasqyrat e fluksit të Mjeteve Monetare përfshin MM (arkëtimet në MM dhe depozitat me afat) dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare (investimet afat-shkurtra, nëse ka, të cilat janë shumë likuide dhe menjëherë të konvertueshme në një vlerë që njihet me siguri dhe vlera e të cilave ndryshon shumë pak).
Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në pasqyrën e fluksit të Mjeteve Monetare nuk përfshin investimet në letrat me vlerë të listuara, investimet me një datë maturimi fillestare afati i të cilës është mbi tre muaj dhe pa një klauzolë përfundimi më të hershëm të këtij afati, ose llogaritë bankare që kanë kufizime në përdorim, kufizime këto të ndryshme nga ato të cilat janë si pasojë e rregullimeve specifike në një shtet ose sektorë të aktiviteteve (kontrollet e këmbimit, etj). Overdraftet bankare konsiderohen si financim dhe si rrjedhim përjashtohen nga Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare. Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në bilancin kontabël korespondojnë me Mjetet monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare sipas përkufizimit të mësipërm.

3.3 Aktivet financiare

Shoqëria i klasifikon aktivet financiare në Llogaritë e Arkëtueshme nga Klientat dhe në Kërkesa të tjera të Arkëtueshme. Manaxhimi vendos për klasifikimin në momentin e njohjes fillestare. Aktivet financiare paraqiten në bilanc me vlerën neto nga zhvlerësimi nëse ka. Llogari të Arkëtueshme njihen si aktive atëherë kur njësia ekonomike bëhet palë e një kontrate dhe, si rrjedhim, ka një të drejtë ligjore për të marrë mjete monetare nga klientat e saj.

Njohja fillestare e kërkesave për t'u arkëtuar nga klientat ndodh derisa mallrat ose shërbimet e porositura janë nisur për tek klienti, kanë mbërritur tek klienti dhe jane pranuar prej tij, ose shërbimi është kryer. Kërkesat për tu arkëtuar vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuara me koston e amortizuar (kosto fillestare minus arkëtimet e bëra, minus

zhvlerësimet nga borxhi i keq nëse ka) pavarësisht nga qëllimi i njësisë për t'i mbajtur ato deri në maturim.

3.3 Aktivet financiare-vazhdim

Një zhvlerësim për rënie vlere të të drejtave për t'u arkëtuar krijohet atëherë kur është evidente që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje që t'i arkëtojë të gjitha shumat ashtu siç ishte parashikuar në termat fillestare të kërkesave për tu arkëtuar. Konsiderohen tregues të rënies së Vlerës së Llogarive të Arkëtueshme: Vështirësi të rëndësishme financiare të debitorit, ndoshta debitori ka hyrë në rrugën e falimentimit ose riorganizimit financiar, dhe moskryerja apo vonesat në pagesa.

Shoqëria vlerëson cdo vit mundësinë e arkëtimit të llogarive të arkëtushme për secilin klient apo debitor dhe kur një Llogari e Arkëtueshme vlerësohet që nuk mund të arkëtohet, ajo regjistrohet në shpenzimet dhe në Llogarinë e kërkesave të Arkëtueshme. Nëse më pas arkëtohet shuma të cilat janë çrregjistruar, atëherë kreditohen shpenzimet e shitjes dhe administrimit për këto shuma. Shuma e zhvlerësimit është diferenca midis vlerës neto kontabël të aktivit dhe vlerës neto aktuale të flukseve të ardhsme të vlerësuar, të diskontuara me normën e interesit efektive. Shoqëria nuk ka llogaritur zhvlerësim të klientëve për vitin raportues

3.4 Inventarët

Inventarët njihen, në përputhje me përcaktimet e bëra në SKK 4 "Inventarët", kur shoqëria i kontrollon apo zotëron ato ekonomikisht apo ligjërisht, kur mbart të gjitha reziqet dhe përfitimet në lidhje me to, dhe kur kostoja matet në mënyrë të besueshme.
Në hyrje inventarët e mallrave dhe materialeve vlerësohen me koston e tyre që përfshin tërësinë e çmimeve të blerjes dhe të shpenzimeve të bëra deri në sjelljen e tyre në shoqëri kur këto kosto mund të indentifikohen me besueshmëri. Produktet e gatshme vlerësohen në hyrje me koston e prodhimit të tyre (duke përfshirë shpenzimet indirekte të prodhimit nëse është rasti). Në bilanc inventarët paraqiten të vlerësuara me vlerën neto, pra më të voglën midis kostos (dhe vlerës neto të realizueshme). Kostoja matet me metodën e mesatares se ponderuar. Vlera neto e realizueshme është e ardhura e parashikuar nga shitja në një periudhë normale të aktivitetit minus kostot e parashikuara të shitjes. Shiko shen. 7

3.5 Aktivet e Afatgjata Materiale (AAM)

(i) Njohja dhe vleresimi

AAM vlerësohen në hyrje me kosto historike. AAM paraqiten në Bilanc me koston e amortizuar (koston historike minus amortizimin e akumuluar minus zhvlerësimin nga ulja e vlerës (nëse ka). Kosto historike përfshin shpenzimet që i përkasin direkt blerjes së elementëve. Kostot e kryera më vonë përfshihen në vlerën e mbartur të aktivit ose njihen si një aktiv më vete, sipas rastit, vetëm nëse është e mundshme që ky element të sjellë hyrje të përftimeve të ardhshme ekonomike në shoqëri dhe kostoja e këtij elementi të mund të matet me besueshmëri. Të gjitha shpenzimet e mirëmbatjes dhe riparimit regjistrohen si shpenzime në periudhën që ato kryhen dhe paraqiten në zërin e shpenzimeve operative.

(ii) Amortizimi

Amortizimi i AAM llogaritet dhe njihet në pasqyren e të ardhurave dhe shpenzimeve me metoden e vleres se mbetur me norma te cilat jane te peraferta me jetegjatesine mesatare te parashikuar te perdorimit. Toka dhe aktivet në proces nuk amortizohen.

Normat mesatare të amortizimit per grupe të AAM, të përdorura në ndërtimin e PF për AAM në kontroll të shoqërisë jane te paraqitura si me poshte:

3.5 Aktivet e Afatgjata Materiale (AAM)-vazhdim

	Norma Mesatare Amortizimit %	*Metoda Llogaritjes*
Pajisje informatike	25%	Me vleren e mbetur
Mobilje dhe Orendi	20%	Me vleren e mbetur
Makineri dhe pajisje	15%	Me vleren e mbetur
Automjete	20%	Me vleren e mbetur
Ndertesa	5%	Me vleren e mbetur

3.6 Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Shoqëria zbaton politikat e shtyrjes të shpenzimeve të cilat do të sigurojnë të ardhura në periudhat e mëvonshme. Po ashtu ajo shpërndan në vartësi të përdorimit dhe sigurimit të të ardhurave edhe shpenzimet e parapaguara.

3.7 Detyrimet

Shoqëria i klasifikon detyrimet në afatshkurtëra dhe afatgjata.

Detyrimet afatshkurtëra klasifikohen në Detyrime tregtare/Llogari të pagueshme ndaj furnitorëve dhe në detyrime të tjera. Llogaritë e pagueshme dhe detyrimet tregtare të tjera njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas në bilanc paraqiten të vlerësuara me koston e amortizuar.

Detyrimet ndaj shtetit për tatimet dhe për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore jane paraqitur me shumen e tyre te llogaritur sipas kerkesave ligjore në fuqi më datën e ndërtimit të pasqyrave financiare. Huamarrjet afatshkurtër njihen fillimisht me vlerën e drejtë, pa përfshirë kostot e transaksionit.

Huatë më pas vlerësohen me koston e amortizuar: çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huasë.

Huatë klasifikohen si detyrime afatshkurtra, me përjashtim në rast se Shoqëria ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit kontabël.

Detyrimet afatgjata vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuara me koston e amortizuar. Cdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huasë duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet

Të ardhurat përfshijnë të ardhurat nga shitja e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë aktivitetin kryesor të shoqërisë, neto nga TVSH dhe nga taksat e tjera. Ato njihen kur ekziston një marrëveshje e vazhdueshme me klientin, dorëzimi është realizuar apo shërbimi është kryer, dhe rreziqet e përfitimet e pronësisë së produktit/shërbimit i janë transferuar klientit, vlera e të ardhurave mund të matet me besueshmëri dhe është e mundur që përfitimet që lidhen me transaksionin mund të hyjnë në Shoqëri.
Të ardhurat nga sherbimet e kryera njihen kur janë kryer sherbimet pavarësisht nëse ato janë faturuar, arkëtuar ose jo.
Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëhere kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen. Shoqëria ka zbatuar parimin e krahasimit të të ardhurave me shpenzimet brenda të njëjtës periudhë.

Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre pavarësisht nëse janë faturuar apo paguar ato.

3.9 Përfitimet e personelit

(i) Kontributet per sigurime shoqerore dhe te ngjashme

Shoqeria, gjate aktivitetit te saj normal, kryen pagesa ne emer te saj dhe te punonjesve te saj per kontributet per sigurimet shoqerore dhe shendetesore ne pajtim me legjislacionin ne fuqi. Kostot perkatese te bera ne emer te Shoqerise ngarkohen ne pasqyren e te ardhurave me ndodhjen e tyre.

3.10 Provizionet

Provizioni njihet kur Shoqeria ka nje detyrim aktual qe ka lindur nga nje ngjarje e shkuar, shlyerja e te cilit pritet te shoqerohet me dalje te burimeve dhe mund te behet nje vleresim relativisht i sakte i shumes se detyrimit. Në periudhën raportuese shoqëria nuk ka llogaritur provizione.

3.11 Tatimi mbi fitimin

Shoqëria zbaton kërkesat e SKK 11 për tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë mbi fitimin. Shoqëria për llogaritjen e tatimit aktual mbi të ardhurat bazohet në normën e tatimit që përcaktohet në ligjet për tatimet që janë në fuqi në datën e ndërtimit të bilancit kontabël.

Fitimi i tatueshëm është llogaritur duke u bazuar në rezultatin kontabël dhe duke e korigjuar atë me shpenzimet e panjohura sipas përcaktimit të ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat". Manaxhimi vlerëson periodikisht gjendjen lidhur me tatimin e rimbursueshëm duke u bazuar në situatat në të cilat rregullimet tatimore që zbatohen janë subjekt i interpretimit dhe përcakton provizione kur e shikon të përshtatshme bazuar në shumat që parashikon ti paguajë ndaj zyrës së tatimeve. Shoqëria nuk ka patur diferenca të përkohshme dhe nuk ka njohur tatim të shtyrë në PF të vitit 2019.

4. Mjetet monetare

Në këtë grup të aktiveve paraqitet gjendja e mjeteve monetare në llogaritë bankare dhe në arkat e shoqërisë. Konvertimi i gjendjes në monedhë të huaj në arkë dhe bankë është bërë me kursin e datës 31.12.2020 të shpallur nga Banka e Shqipërisë, Diferencat e rezultuara nga rivlerësimi i likuiditeteve në monedhë të huaj janë sistemuar në rezultat. Gjendja e mjeteve monetare dhe te ngjashme në fund të periudhës 2020 paraqitet si vijon:

Pershkrimi I Llogarive	31-Dhjetor-20	31-Dhjetor-19
Mjete monetare në bankë	2,719,762	4,883,178
Mjete monetare në arkë	457,850	490,450
Total	3,177,612	5,373,628

5. Kerkesa të arkëtueshme

Në këtë zë paraqiten kërkesat ndaj klientave gjendje të paarkëtuar në 31 Dhjetor 2020. Ato paraqiten me vlerën neto nga zhvlerësimi nga borxhi i keq. Shoqëria nuk ka llogaritur borxh të keq për vitin 2020. Një paraqitje e përbërjes së kërkesave të arkëtueshme ndaj klientave jepet në tabelën vijuese:

5. Kerkesa të arkëtueshme -vazhdim

Pershkrimi I Llogarive	31-Dhjetor-19	31-Dhjetor-19
Kliente per sherbime, mallra dhe produkte	3,557,050	3,635,972
Total	3,557,050	3,635,972

Dinamika e të drejtave ndaj klientëve paraqitet si vijon:

Pershkrimi	2020
Gjendja 01 Janar	**3,635,972**
Rritjet Gjate periudhes ushtrimore	120,135,116
Pakesimit gjete periudhes ushtrimore	-120,214,038
Gjendja 31 Dhjetor	**3,557,050**

6. Kerkesa të arkëtueshme të tjera

Në këtë zë të bilancit paraqiten kërkesat e shoqërisë ndaj të tretëve që nuk lidhen me shitjen e shërbimeve dhe të mallrave. Ne fund të vitit 2020 një paraqitje e përbërjes e tyre si vijon:

Pershkrimi i Llogarive	31-Dhjetor-20	31-Dhjetor-19
Te Tjera	1,084,994	899,837
Total	1,084,994	899,837

7. Inventaret

Në këtë zë paraqitet vlefta e inventarëve të lëndëve të para dhe produkteve te gatshme gjendje në datën e ndërtimit të PF. Shoqëria prodhon produkte sipas kërkesës së klientëve, dhe gjendja e produkteve te gatshme në fund të vitit 2020 perfaqëson vlerën e produkteve të prodhuara për porositë e klientëve, e cila nuk u është faturuar akoma klientëve. Ajo përdor metodën e inventarizimit periodik për evidentimin në kontabilitet të gjendjes dhe lëvizjes të inventarëve. Inventarët janë vleresuar me kosto, e cila është konsideruar nga drejtimi i shoqërisë si më e vogla e krahasuar me çmimin e parashikuar të shitjes minus shpenzimet e parashikuara të përfundimit të shitjes. (Shiko shen 3.4.) Metoda e kostos së përdorur është metoda e mesatares së ponderuar. Inventarët paraqiten si vijon:

Pershkrimi i Llogarive	31-Dhjetor-20	31-Dhjetor-19
Materiale të para	61,031,083	60,144,341
Produkt i gatshem	12,474,795	13,021,872
Materiale te tjera Inventar I imet	5,542,029	3,667,282
Total	79,047,907	76,833,495

8. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Paraqesin shumat e shpenzimeve të kryera dhe që do të shpërndahen në periudhat e ardhme.

Pershkrimi I Llogarive	31-Dhjetor-19	31-Dhjetor-19
Shpenzime te periudhave te ardhshme	3,118,815	347,491
Parapagime	-	-
Total	3,118,815	347,491

9. Aktivet Afatgjata

Gjendja dhe shtesat e pakësimet e Aktiveve Afatgjata Materiale dhe e amortizimeve të tyre gjatë vitit 2020 paraqiten si në tabelën vijuese:

Aktivet Afatgjata Materiale me vlere fillestare 2020

Emertimi	Gjendje 31/12/2019	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2020
1-Toka	22,612,350			22,612,350
2-Ndertesa	63,749,394	80,870		63,830,264
3-Instalime teknike, makineri, pajisje	61,483,554	3,346,556	3,549,284	61,280,826
4-Makineri, Pajisje, Aksesor te linjes	113,225,951			113,225,951
5-Pinceta Metalike	71,405			71,405
6-Vegla Pune	1,502,707			1,502,707
7-Mobilje dhe pajisje zyre	2,733,562	820,961		3,554,523
8-Pajisje informative	19,590,452	680,389	64,947	20,205,894
9-Te tjera	2,549,638	155,325		2,704,963
10-Makina	3,828,960			3,828,960
Totali	**291,347,973**	**5,084,101**	**3,614,231**	**292,817,844**

Amortizimi A.A.Materiale 2020

Emertimi	Gjendje 31/12/2019	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2020
1-Toka	-			-
2-Ndertesa	12,458,410	2,139,146		14,597,556
3-Instalime teknike, makineri, pajisje	38,780,788	10,047,396	2,285,151	46,543,033
4-Makineri, Pajisje, Aksesor te linjes	48,757,173			48,757,173
5-Pinceta Metalike	57,865			57,865
6-Vegla Pune	751,141			751,141
7-Mobilje dhe pajisje zyre	1,366,092	325,264		1,691,356
8-Pajisje informative	11,158,700	1,857,786	16,237	13,000,249
9-Te tjera	1,610,232	156,568		1,766,800
10-Makina	1,378,426	408,422		1,786,848
Totali	**116,318,827**	**14,934,582**	**-**	**128,952,021**

Vlera Kontabel Neto e A.A.Materiale 2020

Emertimi	Gjendje 31/12/2019	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2020
1-Toka	22,612,350			22,612,350
2-Ndertesa	51,290,984			49,232,708
3-Instalime teknike, makineri, pajisje	22,702,766			14,737,794
4-Makineri, Pajisje, Aksesor te linjes	64,468,778			64,468,778
5-Pinceta Metalike	13,540			13,540
6-Vegla Pune	751,566			751,566
7-Mobilje dhe pajisje zyre	1,367,470			1,863,167
8-Pajisje informative	8,431,752			7,205,645
9-Te tjera	939,406			938,163
10-Makina	2,450,534			2,042,110
Totali	**175,029,147**	**0**	**0**	**163,865,821**

9. Aktivet Afatgjata-vazhdim

Në bilanc Aktivet Afatgjata paraqiten për çdo grup me vlerën neto pa amortizimin e akumuluar.

Llogaritja e amortizimit të AAM është bërë duke marre parasysh kohën e hyrjes së AAM. Normat e amortizimit të përdorura (referoju shënimit 3.5 (ii)), janë në përputhje me kërkesat e SKK 4 për të siguruar një shpërndarje të saktë të kostos së AAM në koston e periudhave që ato përdoren për sigurimin e të ardhurave. Norma e amortizimit për kategorinë "Makineri dhe pajisje" është 15% për vitin 2020 për shkak të investimeve të kryera për mirëmbajtjen e makinerive të cilat vlerësohet se kanë rritur jetën e aktiveve.
Në zërin Aktive të tjera afatgjata jomateriale përfshihet "Disenjo Industriale" Neto nga Amortizimi i akumuluar (ku norma e amortizimit të aplikuar është 15%)

	31-Dhjetor-20	31-Dhjetor-19
Aktive të tjera afatgjata jomateriale	61,175	71,970

10. Të drejta të tjera aktive afatgjata

Në bilanc ky zë paraqet të drejtën që njësisë i rrjedh nga kontrata e qirasë financiare për të kredituar TVSH-në sipas planit të amortizimit të kredive. Gjendja e tij ne fund te vitit 2020 eshte e konvertuar me kursin e dates se fundit te vitit, dhe diferencat jane kaluar ne rezultat. Shuma e ketij zeri paraqitet si vijon:

Pershkrimi	31-Dhjetor-20	31-Dhjetor-19
Të drejta të tjera afatgjata	3,607,905	4,557,180
Total	**3,607,905**	**4,557,180**

11. Huat dhe obligacionet afatshkurtra

Paraqet tepricen e llogarise se overdraftit bankar afatshkurter ne Euro qe ka marre shoqeria per plotesimin e nevojave te saj afatshkurtra. Gjendja e tij ne fund te vitit 2020 eshte e konvertuar me kursin e dates se fundit te vitit, dhe diferencat jane kaluar ne rezultat. Paraqet dhe huatë afatshkurtra që ka shoqëria kundrejt bankave. Shuma e ketij zeri paraqitet si vijon:

Pershkrimi	31-Dhjetor-20
Huat afatshkurter – Overdraft	2,399,911
Huamarrje të tjera afatshkurtra – Banka	369,500
Total	**2,769,411**

12. Të pagueshme ndaj furnitorëve

Në këtë zë të bilancit paraqiten detyrimet ndaj furnitorëve ende të papaguara në fund të vitit 2020. Detyrimet ndaj furnitorëve në monedha të huaja janë konvertuar me kursin e datës së fundit të vitit dhe diferencat kanë kaluar në rezultat. Përbërja e këtyre detyrimeve paraqiten si vijon:

Pershkrimi	31-Dhjetor-20	31-Dhjetor-19
Furnitore	11,351,528	12,234,488
Total	**11,351,528**	**12,234,488**

Në furnitorët e aktivitetit kryesor peshën kryesore e zënë detyrimi ndaj furnitorëve për

blerjen (importimin) e mallrave për aktivitetin kryesor të shoqërisë.

Dinamika e detyrimeve ndaj furnitorëve paraqitet si vijon:

Pershkrimi	2020
Gjendja më 1 Janar	**12,234,488**
Rritjet Gjate periudhes ushtrimore	90,451,240
Pakesimit gjate periudhes ushtrimore	-91,334,200
Gjendja më 31 Dhjetor	**11,351,528**

13. Të pagueshme ndaj punonjësve kontribute dhe te tjera te ngjashme

Në datën 31 dhjetor 2020 shoqëria ka detyrim për paga si vijon, te cilat jane shlyer ne Janar 2021.

Pershkrimi	31-Dhjetor-20	31-Dhjetor-19
Detyrime per paga punonjesit	1,460,129	1,349,861
Total	**1,460,129**	**1,349,861**

14. Të pagueshme për detyrime tatimore

Në këtë zë paraqiten detyrimet ndaj shtetit për Tatimet e taksat si dhe detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore gjendje të papaguara më 31 dhjetor 2020 dhe që janë paguar në vitin 2021. Një paraqitje e përbërjes së këtij zëri jepet në tabelën vijuese:

Pershkrimi	31-Dhjetor-20
Shteti Sigurimet Shoqerore e Shendetsore	352,704
TAP	30,365
Shteti TVSH e Pagueshme	279,098
Tatimi ne Burim	44,309
Total	**706,475**

15. Hua të tjera

Në këtë zë të DASH paraqiten shumat per financimin e ortakut per nevoja te shoqerise.

Pershkrimi	31-Dhjetor-19
Të drejta dhe detyrime ndaj ortakëve dhe aksionerëve	68,975,344
Dividentë për t'u paguar	6,371,785
Total	**75,347,129**

16. Të tjera detyrime afatgjata

Ky zë të DAGJ paraqet shumën e huas afatgjatë që shoqëria ka marrë sipas marrëveshjes që ka me banken dhe me te trete te tjere.

Pershkrimi	31-Dhjetor-20	31-Dhjetor-19
Huamarrje të tjera afatgjata - Banka	27,364,159	31,220,270
Hua te tjera	41,128,000	41,128,000
Total	**68,492,159**	**72,348,270**

17. Kapitalet e veta

Gjendja e kapitaleve të veta më 31 dhjetor 2020, sipas zërave kryesorë të tyre të paraqitura në bilancin kontabël paraqitet si vijon:

Pershkrimi	31-Dhjetor-20	31-Dhjetor-19
Kapitali aksionar	61,000,000	61,000,000
Rezerva ligjore	9,752,179	9,752,179
Rezerva të tjera	1,767,656	79,542
Fitimet e pashpërndara	23,878,534	23,878,534
Fitimi (humbja) e vitit financiar	996,079	3,376,114
Total	**97,394,448**	**98,086,369**

18. Të ardhurat

Shoqëria i ka paraqitur të ardhurat dhe shpenzimet duke ndërtuar Pasqyrën e të ardhurave sipas natyrës.

Pershkrimi	31-Dhjetor-20	31-Dhjetor-19
Te ardhura nga shitja e produktit dhe punimeve	111,395,046	134,493,336
Total	**111,395,046**	**134,493,336**

18.1 Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit

Shuma e këtij zëri paraqitet si vijon:

Pershkrimi	31-Dhjetor-20	31-Dhjetor-19
Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	13,367	78,513
Total	**13,367**	**78,513**

18.2 Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces

Shuma e këtij zëri paraqet ndryshimin e vlerës se prodhimit në proces ne vitin 2020 e cila përfundon në vitin 2021 si dhe te ndryshimit te PG. Si rezultat në datë 31.12.2020 kjo është gjëndje në librat e shoqërisë dhe është paraqitur në këtë zë.

Shuma e këtij zëri paraqitet si vijon:

Pershkrimi	31-Dhjetor-20
PG në datën 31.12.2018	-13,021,872
PG në datën 31.12.2019	12,474,795
Ndryshim gjendje produktesh	**--547,077**

19. Materiale te konsumuara (KMSH)

Ne kete ze perfshihen kostoja e mallrave te shitur si dhe kostoja e materialeve te perdorura per ambalazhinin e tyre gjate vitit ushtrimor. Ne koston e materialeve te para shoqeria ka ngarkuar te gjitha kostot direkte te tyre qe sherbejne per te siguruar keto materiale, si taksa doganore, shpenzime transporti, etj. Permbajtja paraqitet si vijon:

Pershkrimi	31-Dhjetor-20
Blerje materiale të para	54,936,426
Blerje materiale të tjera ndihmese	701,225
Total	**(55,637,650)**

20. Shpenzime personeli

Në shpenzimet për personelin, janë përfshirë shpenzimet për paga, shpërblime dhe sigurime shoqërore e shëndetësore të llogaritura gjatë vitit 2020. Gjatë vitit 2020 shoqëria ka llogaritur, deklaruar dhe paguar në përputhje me kërkesat ligjore tatimin mbi pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetsore për punonjësit. Përbërja e shpenzimeve të pagave paraqitet si vijon:

Pershkrimi	31-Dhjetor-20	31-Dhjetor-19
Shpenzime per paga	15,210,283	15,340,520
Shpenzimet e sigurimeve shoqerore e shendetsore	2,559,593	2,558,498
Total	**17,769,876**	**17,899,018**

Në nën zërin e shpenzimeve për sigurimet shoqërore e shëndetsore paraqiten shuma e kontributeve që llogarit dhe paguan shoqëria mbi fondin e pagave të punonjësve. Kontributet janë llogaritur në përputhje me tarifat dhe mënyrën e parashikuar nga ligji i kontributeve shoqërore e shëndetsore.

21. Shpenzimet e tjera

Përbërja e këtij zëri të shpenzimeve paraqitet si vijon:

Pershkrimi	31-Dhjetor-20
Qira	5,298,515
Blerje,energji,avull,uje	1,166,969
Shpenzime transpoti dhe te ngjashme	414,034
Shpenzime komisione bankare	1,149,455
Sigurime mallra, magazina, njësi prodhimi	706,081
Sigurime njësi administrative (ruajtje objekti)	570,587
Shpenzime telefoni, internet, dhe te ngjashme	905,317
Mirëmbajtje dhe riparime	1,629,602
Shpenzime per taksat vendore & doganore	1,477,370
Sherbime Konsulence, sherbime nga te trete,	1,823,666
Shpenzime kancelari dhe te tjera personeli	417,585
Te tjera	3,019,432
Transferime, udhëtime, dieta	51,240
Diferenca kursi kembimi furnitore, kliente dhe te trete te tjere	-
Total	**18,629,853**

Shpenzimet e qirasë paraqesin qiranë e ambjentit ku ushtron aktivitet shoqeria. Shpenzimet e konsulencës dhe nga të tretët paraqesin kostot e shërbimeve, reklamave, etj. Shpenzimet e tjera, paraqesin pagesat për blerjen e ujit, blerje te ndryshme te tjera, etj.

22. Të ardhurat dhe shpenzime për interesa

Përbërja e këtij zëri paraqitet si vijon:

Pershkrimi	31-Dhjetor-20	31-Dhjetor-19
Te Ardhura nga Interesi	168	901
Te Ardhura te tjera financiare	1,468	
Shpenzime nga Interesi	(2,055,236)	(1,992,466)
Shpenzime financiare te tjera	(21)	
Total	**(2,053,621)**	**(1,991,565)**

23. Fitimet dhe humbjet nga këmbimi

Paraqesin fitimet dhe humbjet e vërtetuara gjatë vitit nga kryerja e transaksioneve në monedhë të huaj si dhe nga konvertimi në lekë me kursin e fundit të vitit e gjendjeve të likuiditeteve të shprehura në monedhë të huaj. Paraqitja e tyre jepet në tabelën vijuese:

Pershkrimi		31-Dhjetor-20
Fitimi nga Kurset e kembimit		
	Fitime nga azhornimi i Arkes/Bankes	10,908
Humbje nga Kurset e kembimit		
	Humbje nga azhornimi i Arkes/Bankes	(225,054)
	Total	**(214,146)**

24. Tatimi aktual

Shoqëria ka rezultuar me një fitim kontabël 1,552,302 lekë. Gjatë vitit ushtrimor 2020 shoqëria ka bërë shpenzime të konsideruara të panjohura për qëllime fiskale ne shumën 2,155,853 leke. Fitimi fiskal i shoqërisë për vitin 2020 rezulton 3,708,155 lekë. Llogaritja e rezultatit fiskal dhe e tatimit mbi fitimin për gjithë vitin 2020 paraqiten si në tabelën vijuese:

Pasqyra e rezultatit tatimor		**Viti 2020**
Fitimi/Humbja e vitit		**1,552,302**
Korigjimet e rezultatit sipas ligjit tatimor:		**2,155,853**
Shpenzime me dok jo të rregullta		
Shpenzime të tjera	*2,143,395*	
Gjoba Penalitete e te ngjashme	*12,458*	
Totali i shpenzimeve të panjohura		**2,155,853**
Fitimi/Humbja i tatueshem para mbartjes se humbjes fiskale		3,708,155
Humbja fiskale nga viti		
Fitimi/Humbja fiskale e vitit		**3,708,155**
Norma e tatimit aktual mbi fitimin		15%
Tatimi aktual mbi fitimin e vitit		556,223
Shpenzimi kontabel i tatimit mbi fitimin		**556,223**

Shoqëria përdor norma amortizimi sa normat tatimore (referoju shënimit 3.5 (ii)).

25. Ngjarjet mbas datës së bilancit

Nuk ka në dijeninë e drejtimit, ngjarje të rëndësishme pas datës së bilancit që do të ishte e nevojshme që të paraqiteshin si rregullime ose informacione shtesë në këto pasqyra financiare.